



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2024:116879

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05793017

**K.DH.Shk II.nr.844/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group” SH.A., me NUI:810545543, me seli në Prishtinë, rruga “Edmond Hoxha” nr.27, kundër debitorit Kuvendi Komunal Mitrovicë, me seli në Mitrovicë, rruga “Mbretëresha Teutë”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Fatos Zeqiri, avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.1327/23 të datës 21.12.2023, me datë **07.06.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania e Sigurimeve “Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group” SH.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 1327/23 të datës 21.12.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 1327/23 të datës 21.12.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar

prapësimin e debitorit të Kuvendi Komunal Mitrovicë të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarrim P.nr. 565/23 i datës 28.07.2023 të Përmbarruesit Privat Irfan Kërçagut, dhe i njëjti Urdhër për përmbarrim në pikën I të dispozitivit është Anuluar, ndërsa në pikën II e ka detyruar kreditorin që më emër të shpenzimet t;ia paguaj debitorit shumën prej 104.00 në afat prej ditësh pas plotfuqishmërisë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), për shkak të shkeljeve esenciale sipas dispozitave të LPP-se, vërtetimin e gabuara dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe zbatimit të dispozitave materiale me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 1327/23 të datës 21.12.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosije.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e kreditorit si e pabazuar si dhe të vërtetohet aktvendimi i gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 1327/23 të datës 21.12.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

**Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group” SH.A., me datën 28.07.2023, ka paraqitur propozimin për përmbarrim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, të dokumentit - Nr.04126/03-2019 të datës 27.03.2019, Faturës Nr.00207/07- 2021 të datës 12.07.2021, Faturës Nr.00211/07-2021 të datës 12.07.2021, Faturës Nr.00212/07- 2021 të datës 12.07.2021, Faturës Nr.00087/10-2021 të datës 06.10.2021, me të cilin e urdhëruar debitorin, që t’i paguaj kreditorit borxhin në shumë të përgjithshme prej 1,881.38 €, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, me ndalimin dhe transferimin e të hollave

në llogarinë e kreditorit, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar ndër të tjerash se fatura me numër 04126/03-2019 e datës 27.03.2019 në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbartimore, nuk është e përshtatshme për përmbartim, ngase e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori dhe si e tillë nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, gjithashtu ka shtuar se kjo faturë përmban një detyrim të parashkruar. Tutje ka theksuar se urdhri përmbartimor nuk i përmban elementet e parapara me ligj, andaj i njëjti është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbartimor, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumë prej 104.00 €, sipas TOAK. Kreditori në përgjigjen në prapësimin të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim. Tutje ka theksuar se është tërësisht e pa pranueshme kërkesa për anulim të urdhrin përmbartimor, pasi që i njëjti është marrë në përputhje me ligjin, si dhe faturat janë në përputhje me nenin 29 paragrafi 3 i LPP-së, ndërsa pretendimet e debitorit se fatura nuk është në përputhje me këtë dispozitë ligjore janë të paqëndrueshme, siç janë të paqëndrueshme edhe pretendimet se urdhri përmbartimor është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të mbetet në fuqi urdhri për përmbartim.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar Shkalla e Parë duke u bazuar në të lartcekurat si më lartë, gjeti se dokumenti, se në rastin konkret Fatura Nr.04126/03-2019 e datës 27.03.2019, Fatura Nr.00207/07-2021 e datës 12.07.2021, Fatura Nr.00211/07-2021 e datës 12.07.2021, Fatura

Nr.00212/07-2021 e datës 12.07.2021, Fatura Nr.00087/10-2021 e datës 06.10.2021, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”

Duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Faturat, në bazë të cilave është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori pasi që e njëjta nuk është protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit - Kuvendi Komunal Mitrovicë dhe nuk mban vulën e pranimit - protokollimit dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbarrim. Meqenëse se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat e lartcekura, si të tilla nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe nuk kanë tipare të përmbarrueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga faturat.

Andaj Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës se Parë, vlerëson se të metat e theksuara si më lartë kanë mundur të trajtohet nga organi përmbarrues, përkatësisht nga përmbarruesi privat dhe atë para lejimit të urdhrin, në kuptim të nenit 38, paragrafi 2 i cili, me të cilin përcaktohet se “Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarrim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për

përmburim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmburjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmburimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë e vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se faturat si dokument i besueshëm, Fatura Nr.04126/03-2019 e datës 27.03.2019, Fatura Nr.00207/07-2021 e datës 12.07.2021, Fatura Nr.00211/07-2021 e datës 12.07.2021, Fatura Nr.00212/07-2021 e datës 12.07.2021, Fatura Nr.00087/10-2021 e datës 06.10.2021 mbi bazën e së cilës është lejuar përmburimi nuk është e nënshkruar nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përmburim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Po ashtu, kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmburjes së detyrimeve që dalin nga fatura respektive, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmburim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K.DH.SH.II.nr.844/24, me datë 07.06.2024**

**Gjyqtarja,**

**Saranda Bogaj Sheremeti**